



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 19.05.2026

A.nr.2001/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2001/2025, të datës 08.12.2025, të parashtruar nga ankuesi Xh.B nga Hani i Elezit, kundër organit të punësimit/Komunës së Hanit të Elezit, në çështjen juridike “*kundërshtim i masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.2001/2025, e datës 08.12.2025, e parashtruar nga ankuesi Xh.B.

II. Anulohet masa disiplinore “Vërejtja me shkrim” e shqiptuar ndaj ankuesit përmes shkresës me numër protokoll 02/9167, të datës 31.10.2025, të Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit.

III. Obligohet Udhëheqësit i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Hanit të Elezit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi, duke hequr masën disiplinore të kontestuar nga dosja personale e ankuesit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Xh.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 27.11.2025 përmes postës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 08.12.2025, dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.2001/2025, kundër masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” të datës 31.10.2025, të Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Hanit të Elezit, ndërsa, kjo e fundit ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 7776/2025, të datës 08.12.2025, të

parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për parashtrimin e ankesës të datës 08.12.2025; Vendim e KPMSHCK-së, i datës 16.09.2025, me A.nr.1455/2025; Vendim i KPMSHCK-së, i datës 26.04.2024, me A.nr.370/2024; Vendim i KPMSHCK-së i datës 16.05.2025, me A.nr.482/2025; Vendim i KPMSHCK-së, i datës 05.04.2023, me A.nr.388/2023; Vërtetim për pushim mjekësor nga QKMF-Ferizaj nga data 06.10.2025-13.10.2025; Vërejtje me shkrim me numër protokolli Nr.02-9167, e datës 31.10.2025; Akt emërim me numër Nr.5674/2024, i datës 04.07.2024; Kopjen e letërnjoftimi të ankuesit XH.B; Kërkesa për pushim; Njoftim për kthimin e pushimit vjetor të vitit 2024; Detajet e pushimit vjetor më datë 20.06.2025; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin i datës 11.11.2025; Raporti vjetor për vitin 2023 dhe 2024; Planifikimi përfundimtar i prokurimit për vitin 2023 dhe 2024; Njoftim për kontratë e datës 10.06.2025 deri më 24.09.2025; Kontratë për punë me numër Nr.09/7082/2025, e datës 28.08.2025; Kontratë për furnizim me numër Nr.09/5421/2025, e datës 18.07.2025; Kontratë për shërbime me numër Nr.09/4143/2025, e datës 09.06.2025; Kontratë për furnizim me numër Nr.09/5141/2025, e datës 10.07.2025; Kontratë për shërbime Nr.09/4549/2025, e datës 19.06.2025; Pliko e datës 27.11.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 10.12.2025; Përgjigjen në ankesë 16.12.2025, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Përshkrimi i detyrave të punës; Vendimet për pushim nga data 10.01.2025 deri më 12.06.2025; Njoftim me E-mail i datës 19.02.2025; Detajet e pushimeve vjetore, e datës 15.12.2025; Dosja e pushimit vjetor nga data 01.01.2025 deri më datë 31.12.2025; E-mail i datës 24.11.2025; Raport mjekësor i datës 24.11.2025; E-mail i datës 20.10.2025; E-mail i datës 22.10.2025; Raportet mjekësore; E-mail i datës 04.07.2025; E-mail i datës 20.10.2025; Përgjigje në ankesë e ankuesit XH.B e datës 16.12.2025; Vendim i KPMSHCK-së i datës 15.03.2022, me A.nr. 72/2022; Përgjigje në kërkesë e datës 06.12.2021; E-mail i datës 09.03.2022; Procesverbalet e bordit të drejtorëve; Vendimet për pushim për periudhën 2023, 2024 dhe 12.06.2025; Dosja e pushimit vjetor e datës 30.11.2021; E-mail me korrespondim prej 20 faqeve; Bisedat telefonike; Fotografi të datës 10.10.2025; Vendim i datës 02.10.2021; Formular i parashtrimit të ankesës i datës 16.10.2025; Raport për prezencën në punë; Njoftim me E-mail i datës 20.10.2025; Inicim për procedurë disiplinore e datës 31.10.2025; E-mail me korrespondim prej 7 faqeve; Ankesë e datës 16.12.2025; Përgjigje e datës 03.11.2025; Vendim me numër protokolli Nr.03/1530, e datës 09.12.2025; Njoftime me E-mail me korrespondim prej 28 faqeve, kërkesën me numër protokolli 02-9169, të datës 31.10.2025, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

-Gjendja faktike

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton:

-Ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr.5674/2024 të datës 04.07.2024, është i punësuar në pozitën Shef i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Hanit të Elezit.

-Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, më datë 31.10.2025, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje me shkrim ” më arsyetim se i njëjti mbanë pozitë në organet drejtuese të partisë së kandidatit të pavarur, dhe gjatë fushatës zgjedhore ka munguar nga puna, duke i lënë shumë punë dhe detyra të prokurimit të pa kryera, njëherë duke kërkuar pushim vjetor e më pastaj ka nxjerr raport mjekësor e kështu duke marr pjesë në aktivitetet politike në shtabin e kandidatit të pavarur. Tutje siç thuhet në vërejtje me shkrim e njëjta është bazuar në fakte të verifikueshme dhe dokumentuara të cilat dëshmojnë shkelje të rënda profesionale, administrative dhe ligjore që rregullojnë funksionimin e sektorit publikë. Nëpunësi ka vepruar në

kundërshtim me nenin 25 të drejtat politike të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Po ashtu nëpunësi nuk ka respektuar orarin e punës dhe nuk ka kryer klikimin e prezencës në punës sipas udhëzimeve të vendosura pranë aparatit të Sistemit të Vijueshmërisë në Punë, që nga data 01.06.2025 deri më 20.10.2025.

-Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton masën disiplinore “Vërejtjes me shkrim” të datës 31.10.2025, të shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, me pretendimet së vërejtja është tendencioze dhe pa asnjë arsye, sepse asnjë nga arsyet e dhëna në vërejtje nuk qëndrojnë. Shton se pretendimi se mbaj pozitë në organet drejtuese politike të një kandidati të pavarur, ngase kandidati i pavarur nuk ka strukturë dhe rrjedhimisht nuk ka as organe drejtuese, për kohën nga data 06-10.10.2025 ka qenë në pushim mjekësor pasi që ka pasur një ndërhyrje kirurgjike, dhe pasi që ka pasur plan të marr pushim vjetor ka pritur për aprovim afro 5 ditë e pastaj e ka anuluar. Lidhur me atë se ka qenë në fushatë elektorale, ankuesi pretendon së kjo i njihet me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sepse, fushata është mbajtur në orën 18:33. Pretendon se është i paqëndrueshëm arsyetimi si në vërejtje se ka munguar në punë nga data 01.06.2025 deri më datë 20.10.2025 dhe përveç vijueshmërisë si dëshmi janë edhe shpalljet e tenderëve në këtë periudhë kohore. Kërkon që të aprovohet ankesa të anulohet vërejtja me shkrim e datës 31.10.2025.

-Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit i'u referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë:

- Nenit 25 paragrafi 1 dhe 2, i cili përcakton: *1. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike dhe të shprehë bindjet partiake vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucionit publik. 2. Nëpunësja/i civil me përjashtim të nëpunëses/it civil të kategorisë së nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues, mund të jenë anëtare/ë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtare/ë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të një partie politike.*
- Nenit 56, ku përcaktohet: *1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar*

apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

- Nenit 57 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; **1.3. vërejtje me shkrim**. 2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil.

Kolegji i Këshillit referuar kuadrit ligjor si me sipër, ka analizuar aktin e kontestuar më ankesë në ndërlidhje më provat e lëndës dhe si rrjedhojë ka konstatuar së masa disiplinore “vërejtje me shkrim” e datës 31.10.2025, është shqiptuar për shkak se ankuesi mbanë pozitë në organet drejtuese të partisë së kandidatit të pavarur, dhe gjatë fushatës zgjedhore (zgjedhje kombëtare), ka munguar nga puna duke i lënë shumë punë dhe detyra të prokurimit të pa kryera dhe se i njëjti nuk ka respektuar orarin e punës dhe nuk ka kryer klikimin e prezencës në punës sipas udhëzimeve të vendosura pranë aparatit të Sistemit të Vijueshmërisë në Punë, që nga data 01.06.2025 deri më 20.10.2025, mirëpo, po për të njëjtat shkelje Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit po më datë 31.10.2025, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit në Komisionin Disiplinor të këtij institucioni, andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, Kolegji erdhi në përfundimin se ankesa është e bazuar, sepse, ndaj ankuesit për shkelje të njëjta janë iniciuar dy procedura, ashtu që, fillimisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka vlerësuar veprimet e ankuesit si shkelje të lehtë duke i shqiptuar masën disiplinore “vërejtja me shkrim” dhe në anën tjetër, po për të njëjta shkelje ka iniciuar procedurë disiplinore, duke i vlerësuar veprimet e njëjta të ankuesit si shkelje të rëndë disiplinore, kështu që, duke qenë se shkeljet e pretenduar sipas masës disiplinore të kontestuar më ankesë nuk i referohen shkelje disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji duke u bazuar në dispozitat materiale si më lartë konstaton se masa e kontestuar duhet të anulohet dhe veprimet e pretenduar nga ankuesi si objekt i masës disiplinore të kundërshtuara duhet të trajtohen nga Komisioni Disiplinor i Komunës së Hanit të Elezit.

Andaj, thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.2001/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Xh.B;
- Organit të punësimit: Kryetarit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.